



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 33 Datë 25 / 07 / 2025

“ PËR MIRATIMIN E SHPRONSIMIT PËR INTERES PUBLIK TË PASURISË PRONË PRIVATE QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “RIKONSTRUKSIONI I TROTUARËVE LAGJIA SHEH ”

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 9 pika 1.2, germa “b” Ligjit Nr. 8561, datë 22.12.1999 i ndryshuar, VKM nr.138 datë 23.03.2000 “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik” i ndryshuar VKM nr.89 date 03.02.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, dhe vlerësimin parapra për këto pasuri. Shkresa me Nr.3845/1 prot datë 26.10.2023 të ASHK Drejtoria Vendore Kavajë si dhe vendimin e Keshillit Bashkiak nr.68 datë 23.12.2024 “Për miratimin programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe buxheti 2025” vendimin e Këshillit Kombëtar të territorit me nr.2 datë 27.04.2018 per PPV për Kavajën, vlerësimi paraprak i pasurisë pronë private ku shtrihet investimi dhe gjurma e projektit është bazuar në gjendjes juridike të pasurisë, të konfirmuara nga Agjensia Shtetërore e Kadastrës Drejtoria Vendore Kavajë, me propozim të kryetarit të Bashkisë Kavajë, Këshillit Bashkiak merr në shqyrtim dhe:

VENDOSI

1. Nisjen e procedurave ligjore të shpronësimit për interes publik, për realizimin e projektit **“RIKONSTRUKSIONI I TROTUARËVE LAGJIA SHEH”** për pasurinë e paluajtëshme të llojit truall, në zonën kadastrale 8552 Kavajë, që preket nga realizimi i këtij projekti.
2. Nga realizimi i projektit **“RIKONSTRUKSIONI I TROTUARËVE LAGJIA SHEH”** preket një pjesë e pasurisë nr. 8/148 vol. 10 faqe 148 e llojit “truall” ndodhur në ZK 8552 Kavajë e regjistruar në emër të bashkëpronarëve Shehu sipas listës.
3. Totali i sipërfaqes që do të shpronësohet për interes publik është 58.4 m2
4. Vlëra paraprake e shpronësimit për interes publik është në shumën 452308 (*katër qind e pesë dhjetë e dy mijë e tre qind e tetë*) lekë e cila do të përballohet nga buxheti i Bashkisë Kavajë.
5. Për vazhdimin e mëtejshëm të procedurave të shpronësimit deri në daljen e VKM-së për shpronësim për interes publik ngarkohen Drejtoria e Kadastrës Urbane dhe Menaxhimit të Aseteve Publike, Drejtoria Juridike, Drejtoria e Burimeve Ekonomike, Drejtoria e Planifikimit Zhvillimit të territorit dhe Menaxhimit të Kontratave.

6. Ky Vendim hynë në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, neni 55, të ligjit nr.139/2015 “Për Vetqeverisjen vendore” i ndryshuar, pas konfirmimit nga institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.



Sekretari i Keshillit Bashkiak
MERI BITURKU

Miratuar me vota 26
Vota Pro 26
Vota Kunder =
Vota Abstenim =
Zbardhur me datë 28/07/2025

KRYETAR
RUDIN HYLYIU

